

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6510
E premte, 14 janar 2022
çmimi 0.40 €

Kosova regjistron
dy viktime dhe 427 raste
të reja me Covid IFAGE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

BASHKIMI EVROPIAN (BE) INSISTON PËR GRUMBULLIMIN E VOTAVE
NË KOSOVË PËR REFERENDUMIN SERB

BE-ja SHTON PRESIONIN NDAJ KOSOVËS PËR REFERENDUMIN E SERBISË IFAGE 4



Bashkimi Evropian (BE) ka shtuar presionin ndaj institucioneve të Kosovës për të lejuar grumbullimin e votave në Kosovë për referendumin kushtetues të Serbisë i cili do të mbahet të dielën. Ndonëse kryeministri Albin Kurti ka refuzuar këtë mundësi në bisedën telefonike që ka pasur me shefin e diplomacisë së Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ky i fundit ka insistuar që të lejohet një gjë e tillë. Këmbëngulja e BE-së për mbajtjen e këtij referendumi në Kosovë është vlerësuar veprim i pamoralshëm

OPINION

KOSOVA E SHPRESËS, KOSOVA
E ZHGËNJIMIT! F. 5

Behxhet Sh.
SHALA –
BAJGORA



AKTUALE



STUDIMI NË SHBA: TË INFektUARIT
ME OMICRON, MË PAK GJASA QË
TË HOSPITALIZOHEN F. 2

LDK-ja DHE PDK-ja ARRIJNË
KOALICION PËR
BASHKËQEVERISJE NË PEJË F. 2

EKONOMI



TARIFA TË REJA TË RRYMËS
NË SHKURT F. 8

FMN-ja PUBLIKON RAPORTIN PËR
ARTIKULLIN IV PËR KOSOVËN F. 8

SPORT



MALISHEVA FOKUSOHET
TE FUTBOLLISTËT ME PËRVOJË,
TRANSFERON SHABANIN F. 10

Haradinaj,
prokurorit: Kishit
mundësi ta kapnit
personin që silte
dokumentet IFAGE 6



BABAI I HYSNI GUCATIT: SHTETI
DUHET TË BËJË MË SHUMË PËR
DJEMTË TANË NË HAGË IFAGE 5

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rusia nuk sheh arsye për të zhvilluar bisedime të tjera me Perëndimin

MOSKË, 13 JANAR - Rusia nuk sheh asnjë arsye për të zhvilluar raund të ri të bisedimeve me Perëndimin në ditët e ardhshme sa iu përket çështjeve të sigurisë, pasi nuk ka pasur përparim këto ditë, ka thënë zëvendësministri i Jashtëm rus, Sergei Ryabkov. "Nuk shoh arsye për të biseduar në ditët e ardhshme, për t'u mbledhur sërish dhe për të nisur diskutimet e njëjta", ka thënë Ryabkov në një intervistë për kanal televiziv në gjuhën ruse, RTVI. Ai i ka akuzuar homologët e Perëndimit për mungesë të "fleksibilitetit" për të zhvilluar negociata në "tema serioze". Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e NATO-s kanë zhvilluar bisedime me Rusinë me qëllim të uljes së

tensioneve me Ukrainën, afër kufirit të së cilës janë pozicionuar mijëra trupa ruse. Raundet e bisedimeve në Gjenevë dhe Bruksel këtë javë kanë përfunduar pa ndonjë marrëveshje. Në muajin dhjetor Rusia ka paraqitur planin që parasheh kufizimin e aktivitetit të Shteteve të Bashkuara dhe NATO-s në vendet e ish-Bashkimit Sovjetik dhe Evropën Lindore, duke thënë se aleanca veriatlantike nuk duhet ta pranojë Ukrainën, apo Gjeorgjinë si anëtarë të rinj. "Ne propozojmë që ta analizojmë secilin artikull", në mënyrë që të jemi të gatshëm për të nënshkruar marrëveshje ligjrisht obliguese, ka thënë



Ryabkov. "Kjo gjë është e pamundshme sot, sepse për elementet kyçe të tekstit, Shtetet e Bashkuara dhe aleatët janë

duke na thënë 'jo'. Ryabkov, i cili ka udhëhequr delegacionin rus në bisedimet me zyrtarët amerikanë në

Gjenevë, ka thënë se është e vështirë që t'u besohet vendeve anëtare të NATO-s. Këto negociata janë zhvilluar pasi Perëndimi shqetësohet se Rusia mund ta pushtojë shtetin fqinj, Ukrainën.

Të mërkurën senatorët e Partisë Demokratike në ShBA kanë kërcënuar me pasoja të rënda nëse Rusia pushton Ukrainën, përfshirë sanksione ndaj presidentit rus, Vladimir Putin dhe bankave ruse.

Ryabkov ka thënë se Rusia është mësuar me sanksione të cilat fillimisht janë aplikuar ndaj Moskës kur ka pushtuar Gadishullin e Krimesë më 2014 dhe se nuk nënshtrrohet ndaj presionit.

Studimi në ShBA: Të infektuarit me Omicron, më pak gjasa që të hospitalizohen

NJU-JORK, 13 JANAR - Të dhënat e një studimi paraprak në Shtetet e Bashkuara tregojnë për një rrezik më të ulët të shtrimit në spitale dhe vdekjes nga varianti Omicron i koronavirusit.

Studimi është kryer duke analizuar pothuajse 70 000 persona që rezultuan pozitivë për sëmundjen Covid-19. Analizat janë bërë nga të dhënat e marra nga sistemi shëndetësor në Kaliforni në periudhën ndërmjet 30 nëntorit dhe 1 janarit, ku dy variantet e koronavirusit, Delta dhe Omicroni, qarkullonin gjerësisht.

Studimi gjeti se personat e infektuar me Omicron kishin përgjysmë më pak gjasa që të hospitalizoheshin, rreth 75 për qind kishin më pak gjasa për kujdes intensiv dhe rreth 90 për qind kishin më pak gjasa të



vdisnin në krahasim me personat e infektuar me variantin Delta. Nga afro 52 000 persona të infektuar me Omicron, asnjëri prej tyre nuk pati nevojë për futje në ventilator, krahasuar me 11

persona nga pothuajse 17 000 të infektuar me variantin Delta. Këto gjetje u bashkohen edhe hulumtimeve të kryera në shtetet e tjera, përfshirë Afrikën e Jugut dhe Britaninë. Këto studime

zbuluan, po ashtu, se infeksionet me Omicron janë më pak të rënda dhe kanë më pak gjasa që të shkaktojnë vdekje. Rezultatet e këtyre studimeve sugjerojnë se Omicroni është "më

pak i rëndë" se Delta dhe ulja e gjasave për zhvillimin e një sëmundje të rëndë nuk është vetëm rezultat i vaksinimit apo infektimit të mëhershëm, tha studimi. Megjithatë, ky studim ende nuk është shqyrtuar nga shkencëtarët e tjerë, prandaj Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) thanë se të dhënat nuk mund të merren si të mirëqena.

Drejtoresha e CDC-së, Rochelle Walensky, u tha gazetarëve se transmetueshmëria ekstreme e Omicronit ende është duke e rënduar sistemin shëndetësor amerikan.

ShBA-ja aktualisht po regjistron mesatarisht 750 000 raste të reja në ditë dhe ka rreth 150 000 hospitalizime nga Covid-19. Ky shtet po regjistron çdo ditë mbi 1 600 viktima.

Në Mal të Zi kapen qindra kilogramë kokainë

PODGORICË, 13 JANAR - Ministri i Punëve të Brendshme të Malit të Zi, Sergej Sekuloviç, ka përgëzuar autoritetet kompetente për një aksion të suksesshëm, ku u kapën qindra kilogramë kokainë. Ai nuk dha më shumë detaje për këtë aksion të zhvilluar në Podgoricë.

Më herët gjatë ditës, deputeti nga partia në pushtet, Marko Millaçi, njoftoi përmes një postimi në "Twitter", se kishte pranuar fotografi të pakove me banane, ku besohet se ishte fshehur kokaina nga

punëtorët e një depoje të zinxhirit të dyqaneve "Voli". Policia dhe Zyra e Prokurorisë Speciale ende nuk kanë dhënë detaje se sa është sasia e kokainës që u kap. Po ashtu, as menaxhmenti i kompanisë "Voli" ende nuk ka reaguar. Prokuroria tha se më 13 janar do të dalë me një deklaratë zyrtare lidhur me këtë aksion. Kjo është hera e dytë në gjashtë muajt e fundit që në Mal të Zi kapet sasi e madhe e kokainës.

Në gushtin e vitit të kaluar, Budimir dhe Marina Kërstoviç

u arrestuan në Podgoricë nën dyshimin se kishin qenë pjesëmarrës në kontrabandimin e 1 400 kilogramëve kokainë që, po ashtu, u gjetën në pako të mbushura me banane. Lidhur me këtë rast, në dhjetor Prokuroria ngriti aktakuzë.

Po në qershor të vitit 2018 zyrtarët doganorë të Malit të Zi gjetën mbi 38 kilogramë kokainë gjatë një inspektimi rutinor në një kontejner të mbushur me banane që po transportohej nga Ekuadori.



Haradinaj, prokurorit: Kishit mundësi ta kapnit personin që sillte dokumentet

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 13 JANAR - Edhe të enjten në Gjykatën Speciale në Hagë ka vazhduar gjykimi ndaj nënkryetarit të OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj. Ai është pyetur nga prokurori nëse ka qenë në dijeni se dokumentet të cilat ishin sjell në zyrat e OVLUÇK-së, e pastaj që ishin bërë publike nga zyrtarët e kësaj organizate, ishin sekrete.

Haradinaj ka thënë se asnjëherë nuk u është konfirmuar se dokumentet në fjalë ishin sekrete, edhe pse ata kishin kërkuar nga hetuesit një gjë të tillë. "Ne ju kemi pyetur edhe dy herët e para, por edhe të tretën, nëse këto dokumente janë sekrete. Asnjëherë nuk kemi marrë konfirmim se këto dokumente janë sekrete. Na është thënë se janë të ndjeshme. Disa prej jush nuk e kanë ditur as a janë sekrete apo jo. Na kanë thënë se nuk janë", ka deklaruar Haradinaj.

Më tutje, Haradinaj i është drejtuar prokurorit të Speciales duke i thënë se nëse Zyra e Prokurorit të Specializuar në Kosovë do të kishte dëshirë t'i kapte personat që sillnin dokumentet e Speciales në zyrat e OVLUÇK-së, e kanë pasur atë mundësi. "Ju nëse kishit dashur keni mundur t'i kapni këta persona që i sillnin dokumentet te ne. Veç dy persona po t'i kishit lënë aty te zyrat, e kishit kapur personin e dyshuar, por nuk keni dashur. Ndoshta do të ishit befasuar edhe ju. Sa na keni përcjell neve keni pasur mundësi

t'i përcillni personat e dyshuar për sjelljen e dokumenteve", ka thënë Haradinaj. Ai ka thënë se personi që kishte sjellë dokumentet herën e parë në zyrat e OVLUÇK-së kishte paralajmëruar edhe dokumente të tjera, andaj do të ishte e lehtë kapja e tij kur të vinte prapë.

Më tutje, Haradinaj është pyetur edhe nëse kanë redaktuar emra në dokumentet që i kanë pranuar në zyrat e OVLUÇK-së. "Këto dokumente nuk janë tonat dhe dikush na i ka sjellë. Vetëm kaq. Nuk kam qit asnjë dokument ku shihet ndonjë emër apo ndonjë shkrim. Çfarë di unë për të redaktuar. Je ka më ngarkon me kompetenca që i ke ti këtu. Po më ngarkon me kompetencat tuaja. Është kompetencë e juaja t'i ruani dokumentet. Unë nuk kam pasur nevojë për të publikuar asnjë send. Asnjë faqe nuk e kam publikuar. Çfarë kam redaktuar kur s'kam publikuar asgjë", ka thënë ai.

Pas insistimit të prokurorit, Haradinaj i është drejtuar atij me fjalët: "Mos e luaj rolin e budallës". "Zoti prokuror, po më vjen keq që po më detyron me këto fjalë: Mos e luaj rolin e budallës duke u bërë sikur s'po e di se çfarë thashë. Edhe një herë kërkoj të ndërrohen përkthyesit se nuk po kupton çfarë janë duke thënë", ka thënë Haradinaj.

Nënkryetari i OVLUÇK-së, i cili është duke u gjykuar në Gjykatën Speciale për rrjedhjen e dokumenteve të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, ka deklaruar se prokurori i Speciales është duke ia imponuar deklaratat



të cilat ai nuk i ka thënë.

Ky reagim i Haradinajt ka ndodhur kur është pyetur nga prokurori nëse mendon se kush bashkëpunon me popullin serb është armik i tij.

Haradinaj ka thënë se asnjëherë nuk e ka deklaruar një gjë të tillë. "Ky është mendimi juaj. Nuk e kam thënë unë atë. Mund ta nxjerrësh procesverbalin dhe e sheh se unë kam deklaruar se armik i imi nuk është populli serb, por Vuçkoviçi dhe njerëzit e tij, njerëz që ju keni bashkëpunuar me ta dhe i keni falënderuar. Ne kemi luftuar dhe tash lufta ka mbaruar. Ne duhet të kemi fqinjësi të mirë me Serbinë, por ka persona në Serbi të cilët kanë bashkëpunuar me ju dhe e kanë mentalitetin e Millosheviqit.

Çdokush që është armik i popullit tim, është armik i imi. E kemi betim familjar këtë, jo vetëm unë, por brez pas brezi", ka thënë Nasim Haradinaj.

Të mërkurën Nasim Haradinaj ka thënë se Dhomat e Specializuar duhet të merren me të gjitha krimet e luftës në Kosovë. Ai ka bërë me dije se nëse kjo gjykatë heton vetëm shqiptarët atëherë do të vazhdojë të jetë kundër kësaj gjykate. I emocionuar ai ka përmendur krimet serbe në Kosovë dhe bashkëpunëtorët e Speciales.

Nënkryetari i OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj dhe kryetari i kësaj organizate, Hysni Gucati, akuzohen nga Gjykata Speciale për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë,

konkretisht për pengim të personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës. "Akuzat e paraqitura në aktakuzën e konfirmuar mbështeten në dyshimin e bazuar mirë se, së paku, midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, z. Gucati dhe z. Haradinaj zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur prej Ligjit të Dhomave të Specializuara, ndër të tjera, të dhëna identifikuese të disa dëshmitarëve (të mundshëm), në tri konferenca shtypi dhe aktivitete të tjera të transmetuara, si dhe përmes shpërndarjes së mëtejshme ku përfshihen deklaratat në rrjete sociale", është thënë në njoftimin e Dhomave të Specializuara.

Sveçla takon ministrin e Punëve të Brendshme të Bavarisë, flasin për bashkëpunimin e ndërsjellë

Prishtinë, 13 janar - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, është pritur në takim nga Joachim Herrmann, ministër Shtetëror i Ministrisë për Punë të Brendshme, Sport dhe Integrim, i Landit të Bavarisë.

Në këtë takim ministri Herrmann ka falënderuar ministrin Sveçla për vizitën dhe ka shprehur mirënjohjen e tij për bashkëpunimin e mirë dhe për marrëdhëniet e shkëlqyera mes dy vendeve. Ai u shpreh për interesimin e tij për fuqizimin e këtij bashkëpunimi edhe më tutje në fushat me interes për të dyja palët.

Ndër të tjera, ministri Herrmann ka theksuar rëndësinë e vazhdimin e bashkëpunimit konkret për luftimin e trafikëve të ndryshme, shkëmbimin e informatave, përfshirë këtu edhe migrimin ilegal si dhe ka shprehur gatishmërinë e tij për vazhdimin e mbështetjes



konkrete për Kosovën.

Me këtë rast, ministri Sveçla ka falënderuar ministrin Herrmann për mikpritjen dhe mbështetjen që Landi i Bavarisë ka dhënë për

Kosovën, sikurse mbështetja e tyre për procese të rëndësishme siç është anëtarësimi në Interpol dhe lehtësimi i procedurave të ndryshme për shtetasit e Kosovës

që jetojnë në Bavari.

Gjithashtu, ministri Sveçla ka kërkuar mbështetjen e tij në votimin që pritet të mbahet në çerekun e parë të këtij viti për

njohtjen reciproke të patentshoferëve. Ai e ka njoftuar ministrin Herrmann me prioritetet dhe rezultatet e arritura deri më tani, sidomos në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe për sfidat konkrete në këtë fushë. "Si ministër i Punëve të Brendshme është e rëndësishme të shpreh gatishmërinë time për të punuar shumë ngushtë në fushat e interesit të përbashkët dhe përmes bashkëpunimit të hapur dhe të sinqertë, komunikimit dinamik, për ta arritur objektivin e përbashkët të rritjes së sigurisë në përgjithësi", ka theksuar Sveçla.

Të dy u pajtuan se do të vazhdojnë të bashkëpunojnë dhe shtojnë projektet e përbashkëta si në fushën e avancimeve të kapaciteteve njerëzore, po ashtu edhe në avancimin e teknologjisë për luftimin e formave të ndryshme të krimit.



BASHKIMI EVROPIAN (BE) INSISTON PËR GRUMBULLIMIN E VOTAVE NË KOSOVË PËR REFERENDUMIN SERB

BE-ja shton presionin ndaj Kosovës për referendumin e Serbisë

Bashkimi Evropian (BE) ka shtuar presionin ndaj institucioneve të Kosovës për të lejuar grumbullimin e votave në Kosovë për referendumin kushtetues të Serbisë i cili do të mbahet të dielën. Ndonëse kryeministri Albin Kurti ka refuzuar këtë mundësi në bisedën telefonike që ka pasur me shefin e diplomacisë së Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ky i fundit ka insistuar që të lejohet një gjë e tillë. Këmbëngulja e BE-së për mbajtjen e këtij referendumi në Kosovë është vlerësuar si veprim i pamoralshëm

Muhamet KOCI

Pristinë, 13 janar - Bashkimi Evropian (BE) ka kërkuar nga Kosova ta lejojë mbajtjen e referendomit kushtetues të Serbisë në Kosovë. Shefi i diplomacisë së Bashkimit Evropian, Josep Borrell, për këtë çështje ka biseduar me udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë.

Ndonëse kryeministri Albin Kurti ka refuzuar mbajtjen e këtij referendumi, shefi i diplomacisë evropiane ka thënë se grumbullimi i votave në Kosovë për referendumin serb duhet të lejohet. "Dje kam biseduar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurtin dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, lidhur me grumbullimin e votave në

Kosovë për referendumin kushtetues që mbahet të dielën në Serbi. Grumbullimi i votave në të kaluarën është bërë me lehtësimin e OSBE-së. Qytetarët duhet të jenë në gjendje që ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre të votimit", ka shkruar Borrelli në llogarinë e tij në "Twitter".

Në këtë bisedë telefonike, kryeministri Albin Kurti ka thënë se qytetarët serbë me shtetësi të dyfishtë do të mund të votojnë vetëm përmes postës apo Zyrës Ndërlidhëse serbe në Prishtinë. Sipas Kurtit, votimi në referendumin e një shteti tjetër, në një territor sovran, nuk është praktikë e pranueshme nga asnjë shtet demokratik. "Gjatë një bisede me përfaqësuesin e lartë të BE-së, Josep Borrell, unë shpreha qëndrimin tonë: Serbët në Kosovë me shtetësi të

dyfishtë mund të votojnë në referendumin e Serbisë përmes postës apo në Zyrën Ndërlidhëse në Prishtinë. Referendumi i një shteti tjetër në një territor sovran nuk është praktikë e pranueshme nga asnjë shtet demokratik", ka shkruar Kurti në llogarinë e tij në "Twitter" pas një bisedës telefonike me Borrellin.

Kushtëzimi i BE-së, i pamoralshëm

Insistimi i BE-së për mbajtjen e referendomit kushtetues serb në Kosovë ka nxitur kundërshtime të shumta në Kosovë. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka vlerësuar se këmbëngulja e BE-së për këtë çështje është e pamoralshme. "Nuk ka çështje më të pamoralshme se që është kushtëzimi i Borrellit për lejim të mbajtjes së referendomit të Serbisë në Kosovë për ndryshime kushtetuese në Serbi në kohën kur mbajtja e referendomit në Kosovë edhe për një çështje minore, siç është tredhja e qenve, është pamundësuar edhe me vetë Kushtetutën e Kosovës e që ishte imponuar nga borrellët para këtij Borrelli, zëdhënësit të

Aleksandër Vuçiqit. Borrellit mund t'i mos pëlqejë dhe sigurisht nuk i pëlqen fakti se Kosova është shtet i pavarur dhe sovran, mirëpo duhet ta respektojë vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe vullnetin e më shumë se 100 shteteve që e kanë pranuar Kosovën, shtet të pavarur dhe sovran", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Sipas këtij këshilli, me këto veprime BE-ja po tregohet jokredibile në rolin e saj si ndërmjetësuese në dialogun Kosovë - Serbi. "Mbajtja apo lejimi për mbajtje të një referendumi të Serbisë në Kosovë ndërlidhet me sigurinë dhe sovranitetin e Kosovës, prandaj qeveria e Kosovës nuk duhet të lejojë në asnjë mënyrë dhunimin e këtij sovraniteti që ia garanton edhe e drejta ndërkombëtare sikur që e detyron edhe Kushtetuta e Kosovës të mos lejojë këtë referendum", ka vlerësuar KMDLNj-ja.

Më tej, ky këshill ka ftuar të gjithë shoqërinë e Kosovës ta kundërshtojë mbajtjen e këtij referendumi. "KMDLNj fton të gjitha subjektet politike opozitare dhe shoqërinë civile të përkrahin kundërshtimin e Qeverisë së Kosovës për mbajtje

të referendomit të Serbisë në Kosovë si shprehje e mbrojtjes së sovranitetit të Kosovës dhe detyrim ndaj respektimit të Kushtetutës së Kosovës. Velko Odallovij po e luan një lojë të ndyrë në përpjekje për ta përçarë skenën politike të Kosovës duke e bërë një prerje midis qeverive të mëparshme dhe qeverisë aktuale përkatësisht duke e satanizuar kryeministrin Albin Kurti e që kjo nuk duhet të lejohet. Bindjet dhe ndasitë politike duhet të lihen anash kur është në pyetje interesi i përgjithshëm dhe i përbashkët për Kosovën", ka vlerësuar KMDLNj.

Edhe njohësit e proceseve politike në vend kanë bërë thirrje për moslejimin e këtij referendumi.

Sipas tyre, referendumi kushtetues është manifestim i sovranitetit shtetëror dhe nacional të një vendi. Më 16 janar, të dielën, qytetarët e Serbisë do të deklarohen me "po" ose "jo" për një pyetje: "A jeni për konfirmimin e aktit për ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Serbisë?".

Këto ndryshime kushtetuese kanë të bëjnë me obligimet që Serbia i ka në fushën e gjyqësorit në rrugën e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Babai i Hysni Gucatit: Shteti duhet të bëjë më shumë për djemtë tanë në Hagë

Prishtinë, 13 janar (ER) - Ish-i burgosuri politik dhe ish-ambasadori i Kosovës në Tiranë, Nait Hasani, i shoqëruar edhe nga Sadik Zeqiri, ish-i burgosur, ka vizituar familjen e Hysni Gucatit në Marinë të komunës së Skenderajt. Ata janë pritur nga kryefamiljari Avdullah Gucati me nipat e tij.

mundim, pasi kishte ndërruar aeroplanët për shkak të linjave jo të rregullta të udhëtimit. Derisa bisedonin edhe për të paraburgosurit në Hagë, ai tregonte edhe një rrëfim të gjatë për sakrificën e tij gjatë luftës në Kosovë, ku deri në përfundim të saj nuk kishte pasur asnjë informatë për familjen e tij.



pjesë e frontit të Koshares. Në kohën e fillimit të luftës, edhe pse kishte 63 vjet, komandanti Rrustem Berisha e kishte lutur të mos bëhej pjesë e frontit, por të shërbente në kuzhinë për ushtarët e UÇK-së.

Por, Avdullah Gucati kishte vendosur që të jetë pjesë e frontit të luftës.

Pas disa ditësh babai i Gucatit kishte kërkuar leje që të niset për Kolsh të Kukësit. Arsyeja e vetme ishte që të merrte ndonjë informatë për familjarët e tij të cilët ishin në Kosovë. Avdullahu nuk kishte asnjë informatë për Hysniun dhe për të tjerët. Madje Hysniu kishte shumë plagë në trup atëkohë. Megjithatë, as vizita në Kolsh nuk i kishte ndihmuar rreth ndonjë informate për gruan, djemtë, nipa e mbesat. Gjithë këtë muhabet baca Avdullah na tregoi në odën e tij mes lotësh. "Këta lot nuk po më dalin për Hysniun, as për presidentin Thaçi, as për Jakup Krasniqin, as për Kadri Veselin, as për Rexhep Selimin, as për Nasim Haradinajn, as për Salih Mustafën dhe Pjetër Shalën, por për vuajtjet e këtij populli që ka përjetuar nga kriminelët serbë. Si popull shpejt i harruam vuajtjet dhe harruam dashurinë për njëri-tjetrin.

Nuk po jemi njëzëri që t'i mbrojmë vlerat e luftës dhe djemtë që po mbahen nëpër burgje me aktakuza të fabrikuara nga Serbia. Shteti i Kosovës duhet të bëjë më shumë për djemtë tanë në Hagë", e përfundon rrëfimin e tij babai i Hysni Gucatit, baca Avdullah.

Nait Hasani së bashku me Sadik Zeqirin këto ditë kanë vizituar edhe familjen e Jakup Krasniqit, ku janë pritur nga bashkëshortja Sevdija dhe fëmijët e tyre. Po ashtu, ata kanë vizituar edhe familjen e Kadri Veselit, ku janë pritur nga vëllai i tij, Ismet Veseli. Hasani dhe Zeqiri, gjithashtu, kanë vizituar edhe familjen e Rexhep Selimit, ku janë pritur nga kryefamiljari Ilaz Selimi. Ish-ambasadori Nait Hasani dhe Sadik Zeqiri kanë paralajmëruar se në ditët e ardhshme do ta vizitojnë edhe familjen e ish-presidentit Hashim Thaçi dhe familjen e Nasim Haradinajt e të Pjetër Shalës.



Nait Hasani e ka njoftuar babanë e Hysni Gucatit për vizitën që kishte pasur ditë më parë në Hagë, ku kishte takuar bashkëluftëtarët e tij që po mbahen në paraburgim. Qëllimi i kësaj vizite ishte që edhe kjo familje dhe familjet e tjera të kuptojnë se ka qytetarë të këtij vendi që nuk i harrojnë në këto kohë të vështira, kur djemtë e tyre po përballen me padrejtësinë e Gjykatës Speciale.

Plaku 86-vjeçar, Avdullah Gucati nga Marina e Skenderajt, ka falënderuar Nait Hasanin dhe Sadik Zeqirin për vizitën.

Avdullah Gucati, edhe pse në moshë të shtyrë, ka vizituar djalin e tij në Hagë dhe gjatë rrugës kishte pasur edhe

Babai i Hysni Gucatit ishte pjesë e luftës çlirimtare dhe ishte vendosur në frontin e Koshares. Gjatë këtij rrëfimi bacës Avdullah i rridhnin edhe lotët. Këta lot nuk ishin për djalin e tij Hysni Gucatin që po mbahet në burgun e Hagës, por lot për një fëmijë të vogël dhe nënën e tij të re që lëshonin Kosovën nga agresori serb, ku gjatë luftës ai i kishte takuar i veshur me uniformën e UÇK-së.

Avdullah Gucati ka punuar në Gjermani në qytetin e Mynhenit dhe duke parë se Kosova kishte nevojë për luftëtarë, pavarësisht se djemtë e tij ishin pjesë e UÇK-së, vendosi të kthehej edhe vetë nga Gjermania e t'i bashkohej luftës çlirimtare duke u bërë



KOSOVA E SHPRESËS, KOSOVA E ZHGËNJIMIT!

Askush nuk ka besuar se....



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

22 vjet pas përfundimit të luftës Kosova nuk është ende e çliruar. Se aq në mënyrë të padinjitetshme trajtohen ata që kontribuuan aq shumë për këtë grimcë lirie dhe "pavarësi" që e kemi.

Që aq lehtë dhe aq turpshëm shkelet mbi gjakun dhe sakrificat e ushtarëve të lavdishëm të së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës.

Që aq lehtë dhe pa asnjë skrupull, për interesa politike dhe të mbajtjes së pushtetit, me çdo kusht marginalizohen roli, sakrifica dhe personaliteti i Atij që tërë jetën ia kushtoi luftës për Liri dhe Bashkim Kombëtar, të Papërsëritshmit dhe të Amshueshmit Bacë Adem Demaçi i cili i dha Kuptim dhe Përmbajtje Luftës për Liri, Pavarësi dhe Bashkim Kombëtar.

Se Komandanti Legjendar, i Pavdekshmi dhe i Përjetshmi Adem Jashari do të shpallet persona non grata në Prishtinë duke mos lejuar ngritjen e një shtatoreje në kohën kur ka të tilla edhe për ata që i shërbyen Jugosllavisë dhe Serbisë, duke luftuar edhe kundër Adem Demaçit si dhe ndaj Adem Jasharit.

Se aq lehtë dhe aq paturpshëm do të shkelen parimet dhe betimi, premtimi dhe zotimi për bashkim kombëtar.

Se më lehtë do të bashkoheshin me Serbinë se me Shqipërinë.

Se do të formohet një kamp përqendrimi në Holandë ku do të mbahen të internuar ata që kontribuuan për liri dhe pavarësi, ndërsa familjet e tyre, si të gjitha

familjet e atdhetarëve shqiptarë që nga viti 1945, me strajcë në krah kalojnë qindra e mijëra kilometra për t'i vizituar të dashurit e tyre të cilët një numër i politikanëve aktualë i konsideron si armiq duke shfaqur një sadizëm të skajshëm për vuajtjet dhe fatin e tyre. Aq më keq, po këta sadistë janë kontribuues për degdisjen e ish-kolegëve, bashkëvuajtësve, bashkëluftëtarëve dhe bashkësakrificuesve. Kjo nuk përkon me natyrën njerëzore, shqiptare, morale e as me traditën. Se aq lirë dhe aq turpshëm do të shiten një numër i ish-të burgosurve politikë që tërë sakrificën e tyre e kanë thjeshtëzuar në një hapësirë karrigeje të përmasave të prapancave të tyre.

Se aq lehtë dhe në mënyrë aq të paskrupullt do të pasurohen një numër i atyre që e sakrificuan jetën për liri të Kosovës kurse tani nuk e sakrifikojnë as edhe një centë të vetëm për ata që luftuan me ta dhe të cilët, më parë e zgjedhin vetëvrasjen, si përfundim i ndershëm i sakrificës së tyre se të plaçkitin çdo gjë që iu bie në dorë. Askush nuk ka besuar se për një numër, jo të vogël të qytetarëve të Kosovës, kontejneri i plehrave është vend i vetëm ku e sigurojnë ekzistencën për vete dhe familjen. E turpshëm, skajshmërisht e pamoralshme.

Nuk kemi besuar se do të jemi në një situatë kur duhet ta ulim kokën para hetuesve, persekutuesve, prokurorëve, gjykatësve, gardianëve që na keqtrajtonin edhe në llogoret e ish-Jugosllavisë

(të gjithë shqiptarë, pjesëtarë të UDB-së dhe shërbimeve jugosllave dhe serbe), me ndjenjën e "fajësisë" se kemi luftuar, jemi torturuar, jemi dënuar dhe jemi vranë për lirinë, frutet e së cilës po e gëzojnë mbetjet e tyre dhe trashëgimia biologjike e tyre sikur janë bijtë dhe bijat, nipat dhe mbesat dhe të tjerët.

Kush ka besuar se deputetët e Kuvendit të Kosovës do ta votojnë për poste jashtëzakonisht të rëndësishme që ndërlihet me sigurinë kombëtare trashëgimtarët e udhësive jugosllavë dhe serbë ndërsa do të përjashtohen ata që sakrificuan çdo gjë për shqiptarët, Kosovën dhe Shqipërinë. Vetëm të poshtit e bëjnë këtë, siç e kanë bërë dhe siç po e bëjnë!

Kush do të besonte se 22 vite pas përfundimit të luftës, kriminelët do të bëhen viktimat kurse viktimat kriminelë krejt shkak i luftës egërshe për pushtet, pa shtet! Më thoni se kush do të besonte se 22 vite pas përfundimit të luftës nderin e nënave, motrave dhe bijave tona do ta përdorin si mjet për të ardhur në pushtet, se gjakun e dëshmorëve të popullit do ta përdorin si profaturë për gllabërim të pushtetit, pasurim përtej çdo terpie dhe se që një grup i vogël qyrrarësh do të bëjnë përpjekje të na imponojnë një standard njerëzor, moral, politik, kombëtar në ndërkohë që ata vet nuk e kanë asnjë prej këtyre.

Dhe shumë të tjera për të cilat as pesimisti më i madh nuk do të besonte se mund të ndodhin. Po ndodhin dhe duket se do të

ndodhin edhe më shumë dhe më keq!

A duhet të dorëzohemi? Jo dhe asnjëherë! Ata që krijojnë vepra që tejkalojnë botën reale duke kaluar në amshim janë engjëjt mbrojtës të së mirës, të së drejtës, të së vërtetës dhe njerëzores. Ata na largojnë të gjitha mëdyshjet morale midis asaj nëse do të përcaktohem për një vdekje të jetueshme apo pavdekësi të vdekshme, midis një çnderimi të dhunshëm dhe nderimi të pandershëm, midis një morali të pamoralshëm dhe një nderi të ashtëzuar, midis një respekti dhe nderimi të blerë me paratë e vjedhura dhe nderimi nga ata që e vlerësojnë nderimin shkak se edhe vet bëjnë jetë të ndershme, midis "heronjve" të sajuar dhe heronjve të dëshmuar, midis këlyshëve të Serbisë dhe shqiponjave të Shqipërisë dhe shumë të tjera midis....!

Horrat nuk kanë jetëgjatësi, mbijetojnë dhe mrizojnë në kuadër të një mandati kohor, aq sa zgjatë nënshtrimi dhe shërbimi i tyre ndaj së keqes. Horra kishte në të gjitha qeveritë paraprake në Kosovë, të tillë ka edhe në qeverinë aktuale. Ishin të mandatuar ata para këtyre, janë të mandatuar edhe disa prej horrave në qeverinë aktuale. Ishin pa vepra ata para këtyre horrave të sotëm dhe do të futen në thesin e harresës, si ata të djeshmit kështu edhe këta të sotëm, pa asnjë dyshim!

Lufta e shqiptarëve për liri nuk është e ditëve tona, ishte që nga koha kur u themelua shteti i Serbisë. Lufta e shqiptarëve për liri

nuk ka përfunduar ende, është pjesë e procesit, deri në bashkimin kombëtar që është i pandalshëm, mund të ketë vonim por nuk ka shpëtim sidomos për ata që e luftuan dhe po e luftojnë bashkimin kombëtar. Që nga fillimi i luftës për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar, luftëtarët e vërtetë ishin pakicë kurse horrat dhe përkrahësit e horrave ishin shumicë. Të tillë janë edhe sot. Ndonëse pritjet ishin tjera për Kosovën dhe Shqipërinë, për çka edhe u bënë aq shumë sakrifica, megjithatë ia ka vlejtur të bëhen këto sakrifica! Është ndërtuar themeli dhe tash duhet të ndërtohet shtëpia e përbashkët e të gjithë shqiptarëve si dhe të atyre që duan të jetojnë në këtë shtëpi me të drejtat dhe detyrimet që i ka shumica. Ia vlen që edhe në të ardhmen të bëhen sakrifica nëse e kërkon situata e që, duket se pashmangshëm do ta kërkojë. Sa më lehtë dhe sa më pak sakrifica, aq më mirë do të jetë! Mos pritni që horrat do të sakrifkohen sepse nuk ka ndodhur në asnjë vend të botës për të ndodhur në Kosovë. Një popull që i shkelë vlerat njerëzore, kombëtare, politike dhe moral, nuk është popull, është bedel popull. Prandaj, respektin më të madh për të gjithë ata që sakrificuan për një qëndresë të vazhdueshme, duke mos e kursyer as jetën e tyre, për të na bindur se vetëm liria nuk ka çmim dhe se për të ia vlen në çdo kohë të jepet jeta. Për fat të keq, kjo kategori sot është më e nëpërkëmbura në Kosovë pikërisht nga horrat vendorë, të përzier dhe ndërkombëtarë!

Kosova regjistron dy viktima dhe 427 raste të reja me Covid

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 JANAR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se të enjten janë regjistruar 427 raste të reja me Covid-19 pas testimit të 5 881 mostrave.

Shkalla e pozitivitetit nga mostrat e marra është 7.26 për qind.

Në 24 orët e fundit nuk janë regjistruar dy viktima.

Autoritetet shëndetësore kanë njoftuar edhe se 31 persona janë shëruar derisa 2 811 persona janë ende aktivë në koronavirus. Prej shpërthimit të pandemisë në mars të vitit 2020, autoritetet e Kosovës kanë regjistruar mbi 163 000 raste të infektimit. Prej këtyre 2 994 persona kanë vdekur.

Kosova ka nisur fushatën e vaksinimit kundër

koronavirusit në mars të vitit të kaluar. Prej atëherë janë dhënë mbi 1.7 milion doza të vaksinës. Qytetarët në Kosovë mund të marrin vakcina të kompanive "Pfizer/BioNTech" dhe "AstraZeneca".

Doza përforcuese e vaksinës

mund të merret pas tre muajve të marrjes së dozës së dytë.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) u ka bërë apel qytetarëve që të vaksinohen me vaksinën kundër Covidit.

Ky institut ka vlerësuar se vaksinimi mbetet arma më e fortë për ta parandaluar hospitalizimin.

IKShPK-ja në apelin e saj ka kërkuar nga qytetarët që t'i respektojnë edhe masat kundër Covidit. "Gjithashtu, apelojmë për vaksinimin me dozën përforcuese dhe dozën e tretë që mund ta marrin të gjithë qytetarët e moshës mbi 18-vjeçare. Vaksinohuni dhe ftoni të tjerët të vaksinohen! Duke u vaksinuar vetë, ju mbroni veten, mbroni edhe njerëzit përreth jush, në rend të parë familjen. Vaksinimi mbetet arma më e fortë për ta parandaluar hospitalizimin", është thënë në apelin e IKShPK-së.

Sipas këtij instituti, është i domosdoshëm kujdesi i shtuar i të gjithëve që në mënyrë strikte të respektohet distanca fizike,



të përdoren maskat, të bëhet dezinfektimi dhe ajrosja e hapësirave, duke pamundësuar dhe shmangur përhapjen

eventuale të mëtejme të infeksionit të Covid-19. "Omicroni është tejet ngjitës, andaj mbani maskat në çdo

vend, mbani distancën mbi dy metra dhe në mjedise të hapura edhe po qe se të gjithë bartin maska!", ka njoftuar IKShPK-ja.

Këshilli Prokurorial siguron transparencë në procesin e zgjedhjes së Kryeprokurorit të ri të Shtetit



PRISHTINË, 13 JANAR - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) më 12 janar 2022, në takimin e 208-me radhë të tij, duke respektuar afatet ligjore, respektivisht Rregulloren nr. 06/2019 për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurore të prokurorive të Republikës së Kosovës, e cila përcakton që konkursi shpallet së paku 90 ditë para skadimit të mandatit të Kryeprokurorit aktual të Shtetit, ka marrë vendim për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e Kryeprokurorit të ri të Shtetit.

KPK-ja i ka njoftuar me kohë të gjithë partnerët ndërkombëtarë dhe vendorë me agjendën e takimit të 208 të saj, ku ishte caktuar si pikë e rendit të ditës propozimi për shpalljen e Konkursit për zgjedhjen e Kryeprokurorit të ri të Shtetit. Këshilli Prokurorial i Kosovës, ashtu siç ka marrë vendim për

shpalljen e konkursit, duke u bazuar në afatet ligjore, do t'i vazhdojë të gjitha procedurat deri në zgjedhjen e Kryeprokurorit të ri, duke respektuar ligjet dhe aktet e tjera nënligjore që rregullojnë këtë proces.

Po ashtu, Këshilli Prokurorial i Kosovës, sikurse në proceset e tjera, edhe në këtë proces do t'i ftojë partnerët ndërkombëtarë për monitorim me qëllim që të jetë sa më transparente zgjedhja e Kryeprokurorit të ri të Republikës së Kosovës.

Këshilli Prokurorial i Kosovës vlerëson lart mbështetjen e vazhdueshme që po japin partnerët ndërkombëtarë, andaj edhe do të vazhdojë të bashkëpunojë për të gjitha proceset e sistemit prokurorial të Kosovës me qëllim të fuqizimit dhe ngritjes së vazhdueshme të efikasitetit të këtij sistemi.

LDK-ja dhe PDK-ja arrijnë koalicion për bashkëqeverisje në Pejë

Pejë, 13 janar - Kryetari i komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ka pritur të enjten në takim kryetarin e Degës së PDK-së në Pejë,

Xhavit Haliti. Në takim është nënshkruar marrëveshja për të qeverisur në Pejë edhe në katër vjetët e ardhshëm, ku nga kjo marrëveshje

LDK-ja do të udhëheqë dhjetë drejtor, ndërsa PDK-ja do të udhëheqë katër drejtor. Palët janë zotuar dhe i kanë siguruar

qytetarët, që fokusi i bashkëqeverisjes së tyre do të jetë interesi i qytetarëve të Pejës ashtu siç ka qenë edhe në dy mandatet e kaluara.



Tarifa të reja të rrymës në shkurt

PRISHTINË, 13 JANAR - Shtrenjtimi i energjisë elektrike dhe rikthimi i bllok-tarifave janë vetëm disa kërkesa që Zyra e Rregullatorit të Energjisë në Kosovë (ZRRE) është duke i shqyrtuar për strukturën e re tarifore.

Të dhënat rreth kësaj strukture ZRRE-ja paralajmëron se do t'i bëjë publike në fillim të muajit shkurt. "Shpresojmë që raportet përfundimtare të publikohen sapo ekspertët e ZRRE-së t'i analizojnë të gjitha të dhënat. Të gjitha palët do të njoftohen në kohën kur raportet do të bëhen publike", thuhet në përgjigjen e ZRRE-së dërguar "Radios Evropa e Lirë". Në muajin dhjetor ky institucion, pas kërkesave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) dhe Kompanisë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO), ka nisur ta bëjë shqyrtimin e jashtëzakonshëm të tarifave të energjisë elektrike. Ky shqyrtim është thënë se ka për qëllim të reflektojë mbi çmimet e ngritura të importit të rrymës si pasojë e krizës globale energjetike.

ZRRE-ja ka bërë me dije se tarifën që do të përcaktohen në këtë shqyrtim do të aplikohen për një vit. Kjo lë të kuptohet se shqyrtimi i rregullt i tarifave, që zakonisht bëhet në prill të çdo viti, eliminohet.

ZRRE nuk jep ndonjë të dhënë se sa mund të shtrenjtohet rryma. Por, Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike (KEDS) ka kërkuar tashmë që rritja të jetë 7 për qind. Konsumatorët e Kosovës aktualisht paguajnë 6.75 centë për kilovat në orë.

Rikthimi i bllok-tarifave, mundësi për kursim të energjisë elektrike

Instituti për Politika Zhvillimore në Kosovë (INDEP) ka kërkuar nga ZRRE-ja rikthimin e bllok-tarifave dhe jo rritje të çmimit të rrymës. Bllok-tarifat kanë qenë pjesë e



strukturës tarifore të energjisë elektrike në Kosovë nga viti 2006 deri në vitin 2017. Sipas tyre, kur një ekonomi familjare ka shpenzuar më shumë se 600 kilovatë rrymë në muaj, çmimi për të ka qenë më i lartë në krahasim me familjet që kanë shpenzuar nën 600 dhe 300 kilovatë në muaj.

ZRRE i ka hequr ato rreth pesë vjet më parë. "Bllok-tarifat konsiderohen nga konsumatorët si të komplikuar për t'u kuptuar", ka thënë ZRRE në atë kohë. Sipas INDEP-it, rikthimi i bllok-tarifave është një mundësi e mirë për kursimin e energjisë elektrike. "Ne konsiderojmë që një strukturë tarifore, që bazohet në konsum të energjisë, do të bënte që të mos kemi shtrenjtimit të energjisë për disa kategori që nuk shpenzojnë shumë", thotë Dardan Abazi, ekspert i

politikave të energjisë në INDEP. "Pra, për këto kategori nuk duhet të ketë rritje të çmimit. Por, një çmim i ri duhet të ndodhë në kategoritë e familjeve që shpenzojnë më shumë energji, mbi 600 kilovatë, apo mbi 1 000 kilovatë", thotë Abazi për "Radion Evropa e Lirë". Sipas një analize të INDEP-it të bërë në kohën kur aplikoheshin bllok-tarifat, qytetarët e kanë kursyer energjinë elektrike. Abazi thotë se në atë kohë mbi 81 për qind e konsumatorëve nuk kanë shpenzuar më shumë se 600 kilovatë në muaj. Sipas INDEP-it, struktura tarifore, që ka ndryshuar në vitin 2017, ka nxitur konsumatorët që të shpenzojnë më shumë energji elektrike, duke filluar përdorimin e saj edhe për ngrohje.

Rikthimin e bllok-tarifave e kërkon edhe KEDS-i, duke thënë se kjo strukturë tarifore do ta lehtësonte sistemin, pasi që konsumatorët do të ngroheshin më pak me rrymë. KEDS-i, në listën e shpenzuesve më të mëdhenj të energjisë elektrike në vitin 2021, ka identifikuar ngrohjen qendrore me rrymë dhe bojlerin. Amvisëritë në Kosovë mund ta kontrollojnë shpenzimin e rrymës në uebfaqen e KESKO-së, pasi të regjistrohen me kodin e konsumatorit që figuron në faturë.

Në fund të vitit të kaluar konsumatorët në Kosovë janë përballur me reduktime të ashpra të energjisë elektrike, por kjo situatë, sipas KEDS-it, është stabilizuar. Zëdhënësi i KEDS-it, Viktor Buzhala, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se me ftohjen e

motit kërkesat për energji elektrike janë rritur. Për ta përmbushur nivelin e konsumit, i cili më datën 11 janar ishte 1232 megavatë në orë, Buzhala thotë se janë duke importuar energji elektrike mbi 500 megavatë me çmime të larta. "Çmimet e importit kanë qenë në rënie nga data 24 dhjetor 2021, por në dy ditët e fundit kanë filluar të rriten. Varet nga kontrata që realizohet por, për momentin, çmimi i energjisë elektrike për megavat shkon deri në 270 euro", thotë Buzhala.

Importi i energjisë elektrike është i pashmangshëm, pasi që termocentralet në Kosovë aktualisht nuk po arrijnë të prodhojnë më shumë se 500 megavatë energji elektrike në orë. Një nga arsytet për nënprodhim është vjetërsia me dekada e termocentraleve.

FMN-ja publikon raportin për artikullin IV për Kosovën



PRISHTINË, 13 JANAR - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka mirëpritur vlerësimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) pas përfundimit të konsultave të Artikullit IV me Kosovën për vitin 2021. Fondi Monetar Ndërkombëtar ka vlerësuar se vendimi i BQK-së për t'i hequr gradualisht masat mbështetëse të lidhura me pandeminë në vitin 2021 ishte i justifikuar. "Ndërkohë që sistemi financiar në përgjithësi ka mbetur i qëndrueshëm dhe rritja e

kredive joperformuese pritet të jetë e kufizuar, forcimi i monitorimit të rrezikut kreditor është thelbësor për të siguruar që provizionet në banka pasqyrojnë ndryshimin themelor në kualitetin e mjeteve dhe se nivelet e kapitalit janë të mjaftueshme për t'i absorbuar humbjet si dhe për ta vazhduar aktivitetin kredidhënës", thuhet në vlerësimet e FMN-së. Më tej theksohet se kapaciteti i autoritetit mbikëqyrës për ta vlerësuar kornizën e

humbjeve të pritura kreditore të institucioneve të rregulluara në kontekstin e zbatimit të SNRF-9 duhet të vazhdojë të përmirësohet. Rifillimi i funksionimit të Bordit të BQK-së do ta mundësojë zbatimin e rekomandimeve të dala nga raportet e Rishikimit të Stabilitetit të Sektorit Financiar dhe Vlerësimit të Masave Mbrojtëse, duke siguruar që funksioni i stabilitetit financiar të raportojë drejtpërdrejt te Bordi Ekzekutiv.

Çfarë do të ndodhë këtë vit në Evropë? Ja cilët janë 4 skenarët

Nga Cas MUDDE "Internazionale"

Viti 2021 filloi me shpresën se prodhimi i një vaksine anti-Covid do t'i jepte fund pandemisë, por përfundoi me një variant të ri të koronavirusit dhe frikën në rritje se Covid-19 do të qëndrojë me ne përgjithmonë.

Si në media ashtu edhe në politikë, viti që sapo lamë pas u dominua sërish nga virusi dhe pandemia. Dhe me shumë mundësi, do të jetë sërish kështu edhe këtë vit. Duke parë vitin 2021, mund të identifikohen të paktën 4 elementë dhe tendenca, të cilat do të vazhdojnë të ndikojnë në politikën evropiane gjatë gjithë vitit 2022.

Mungesa e një orientimi të qartë elektoral

Vitet e fundit janë botuar shumë artikuj mbi "fundin e populizmit" apo mbi "rikthimin e së majtës", të cilët në shumicën e rasteve kanë paraqitur "prova" të përzgjedhura me kujdes për të mbështetur tezën e tyre, duke nxjerrë në pah disa rezultate dhe shpërfillur të tjerat.

Nëse do të fokusohemi tek 4 zgjedhjet më të rëndësishme parlamentare që u zhvilluan në Bashkimin Evropian – Bullgari, Republikën Çeke, Gjermani dhe Holandë – shohim rezultate shumë të ndryshme. E majta ka fituar në fakt vetëm në Gjermani, ndërsa mbetet e qëndrueshme në Holandë, ka humbur shumë në Bullgari (mbi 3 palë zgjedhje), dhe është zhdukur plotësisht në Republikën Çeke.

Po kështu, "e djathta e moderuar" (çfarëdolloj kuptimi që ka ende ky term në shekullin XXI) ishte humbësja më e madhe në Gjermani, por pati një triumf të bujshëm në Bullgari dhe Republikën Çeke. Por krahasuar me kulmin e vitit 2017 (i arritur në vazhden e "krizës së refugjatëve"), populizmi i krahut të djathtë po humbet pikë në 3 shtete, teksa po fiton terren në Holandë.

Pra me përjashtim të Holandës, 3 shtetet e tjera të lartpërmendura, kanë qeveri koalicioni dhe kryeministra që u përkasin grupeve të ndryshme politike në Parlamentin Evropian. Shtatë zgjedhje parlamentare janë planifikuar të mbahen këtë vit në shtetet e Bashkimit Evropian, si dhe disa zgjedhje të rëndësishme presidenciale, veçanërisht në Francë.

Po t'i hedhim një sy sondazheve, tabloja mbetet kaotike dhe nuk shfaqet asnjë prirje e qartë, përveç ndoshta asaj të fragmentimit të vazhdueshëm. Në fakt, mbështetja për partitë më të mëdha mbeti e qëndrueshme gjatë vitit të kaluar. Edhe nëse lindin qeveri të reja, është e vështirë të parashikohet nëse ato



do të jenë kryesisht të majta, të djathta, të moderuara apo populiste.

Polarizim mbi masat kundër Covid-19

Ndërsa shumica e qytetarëve në të gjitha vendet e Evropës, mbështesin masat kryesore të qeverive kundër Covid-19, pakicat kundërshtarë po radikalizohen gjithnjë e më shumë. Në vendet ku nuk është në pushtet, e djathta ekstreme është bërë zëri kryesor i disidentëve, të cilët mbeten një grup shumë heterogjen, që bashkohen me sa duket vetëm nga mosbesimi i përbashkët ndaj qeverive.

Ndërsa shumë parti të ekstremit të djathtë, ishin ndër të parat që kërkuar masa kufizuese në fillim të vitit 2020, shumica kanë ndryshuar pozicionin e tyre, duke vazhduar ta minimizojnë kërcënimin e virusit, madje ndonjëherë duke mohuar edhe ekzistencën e tij. Ndërsa masat kufizuese janë ende në fuqi, ndonjëherë edhe më të rrepta sesa në të kaluarën, protestat janë shtuar dhe bërë më të shpeshta. Aktivistët dhe grupimet e ekstremit të djathtë, janë veçanërisht aktivë në këto mobilizime, por nuk ia kanë dalë të marrin kontrollin e tyre siç ndodhi me protestat kundër refugjatëve në vitet 2015-2016.

Duke pasur parasysh vëmendjen jo-proporcionale që i kanë kushtuar kësaj pakice të zhurmshme media dhe politika, pandemia është shndërruar në temën qendrore të fushatave populiste të ekstremit të djathtë. Gjithsesi, konsensusi i gjerë mbi politika më të ashpra ndaj migracionit, dhe kundërshtimi i tyre ndaj

kufizimeve shtetërore, i pengon ata të mobilizohen seriozisht mbi dy parimet e tyre thelbësore, nacionalizmin dhe autoritarizmin. Ndonëse ka shumë të ngjarë që viti 2022 të ushqejë zhgënjim dhe intolerancë ndaj pandemisë dhe masave kufizuese, mund të supozohet se e djathta ekstreme do përpiqet të vendosë në plan të dytë lëvizjen kundër vaksinimit, por pa arritur të grumbullojë një mbështetje më gjerë mbi temën e luftës kundër emigracionit.

Pandemia nuk e ka ndryshuar botën

Në vitin 2021, disa artikuj sensacionalë e paraqitën Covid-19 si një ngjarje revolucionare, që do të ndryshonte rendin botëror, por ndoshta edhe vetë botën njëherë e përgjithmonë. Megjithatë, gati 2 vjet pas fillimit të pandemisë, "Bota 2.0" duket shumë e ngjashme me "Bota 1.0", të paktën në aspektin politik.

Jo vetëm që janë shfaqur pak parti apo koalicione të reja, por shumica e qeverive mbeten të dominuara nga formacionet që ekzistojnë përpara pandemisë dhe të gjitha krizave të tjera të shekullit XXI. Dhe nëse i referohemi rolit të shtetit, nuk ka pasur një "rivendosje të madhe". Kjo nuk do të thotë se duhet hedhur poshtë mundësia teorike e një "bote të re post-pandemike". Por për momentin ky është vetëm spekulim, pa asnjë provë për ndryshime vendimtare në qëndrime, politika apo rezultate të zgjedhjeve. Përkundrazi, duket se ka një grupim gjithnjë e më të madh njerëzish që e kanë lënë pas pandeminë, apo që duan t'harrojnë sa më parë atë.

Dhe kjo do të dobësojë më tej efektivitetin e politikave të qeverive. Pyetja kryesore në periudhën afatshkurtër dhe atë afatmesme, është nëse pandemia do të ketë ende pasoja të rëndësishme ekonomike, dhe më e rëndësishmja, si do të reagojnë qeveritë kombëtare dhe Bashkimi Evropian.

Tani për tani, pak udhëheqës politikë kanë bërë thirrje për masa shtyrëse, por situata mund të ndryshojë në të ardhmen e afërt. Por duke pasur parasysh faktin që edhe kriza e madhe e vitit 2008 pati efekte tejet modeste në politikën evropiane (kryesisht një ringjallje e përkohshme e partive populiste, dhe një dobësim strukturor i qendrës së majtë), nuk është e thënë që vështirësitë ekonomike që solli pandemia ta transformojnë rrënjësisht kontinentin evropian.

Bashkimi Evropian: Nga Brexit tek demokracia joliberalë

Pas vitit 2016, Brexit ka dominuar prej kohësh shqetësimet e BE-së. Megjithëse u duk sikur procesi kishte përfunduar me marrëveshjen e tregtisë dhe bashkëpunimit BE-Britani të dhjetorit 2020, problemet e fundit me tranzitin e mallrave midis Irlandës së Veriut dhe Britanisë së Madhe, e kanë rikthyer këtë çështje në krye të axhendës politike.

Por tashmë duket se Brukseli e ka kuptuar se kërcënimet e vërtetë për ekzistencën e tij vjen nga lindja. Sulmi kundër demokracisë liberale në Hungari dhe Poloni, ka çuar në marrjen e disa masave konkrete, nga dëbimi de facto nga Partia Popullore Evropiane (PPE) e partisë Fidesz të kryeministrit

hungarez Viktor Orban (edhe pse ishte Orban, ai që e tërhoqi vetë Fidesz nga PPE që në mars), deri në vendimin më të fundit për të bllokuar dhjetëra miliarda euro fonde të destinuar për Budapestin dhe Varshavën.

Për më tepër, qeveritë e reja në Gjermani dhe Holandë, kanë përfshirë në programet e tyre një referencë të qartë mbi rëndësinë që ka në vendet e unionit respektimi i shtetit të së drejtës.

Ndërsa partitë jo-liberale nuk humbën shumë terren gjatë vitit 2021, dy politikanë të shquar nga ky grupim janë larguar nga qendra e vëmendjes.

Në tetor Andrej Babis humbi zgjedhjet dhe udhëheqjen e Republikës Çeke. Në Austri, Sebastian Kurz dha dorëheqjen nga posti i tij si kancelar dhe pak ditë më vonë njoftoi tërheqjen e tij nga politika, ndërsa vazhdojnë hetimet ndaj tij për korrupsion. Këtë vit mund të rrezohet nga pushteti shumë populiste.

Në këtë kuptim, zgjedhjet në Francë, Hungari dhe Slloveni do të jenë shumë të rëndësishme.

Vëmendja kryesore do të jetë tek Franca, ku skenari më i mundshëm është një tjetër përballje në raundin e dytë midis presidentit aktual Emmanuel Macron dhe lideres së së djathtës radikale Marine Le Pen.

Mund të ketë një fitore të re të Macron, edhe pse me një diferencë më të vogël sesa në vitin 2017. Megjithatë, ngritja e kandidatit të ri të ekstremit të djathtë Eric Zemmour në raundin

e parë do të dobësojë pozitën e Marine Le Pen, që mund të mbetet jashtë garës për në raundin e dytë, duke pasur parasysh rritjen në sondazhe javët e fundit të Valérie Pécresse, kandidate epartisë së qendrës së djathtë, Les Républicains (Republikanët).

EURO GLASS
SAINT-DORAIN SEKURIT PILKINGTON ENVERI
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Malisheva fokusohet te futbollistët me përvojë, transferon Shabanin



Skuadra e BKT Superligës, Malisheva, në këtë afat kalimtar është e fokusuar plotësisht te futbollistët me përvojë. Pas Labinot Ibrahimit dhe Fidan Gërbeshit, kjo skuadër e transferoi edhe Xhevdet Shabanin

"Epoka e re"

PRISHTINË, 13 JANAR - Skuadra e Malishevës e ka transferuar futbollistin e njohur Xhevdet Shabani, duke e çuar në tre numrin e përforcimeve në këtë afat kalimtar. Klubi malishevas duket se është i vendosur të sjellë vetëm futbollistë me përvojë të madhe në radhët e veta në mënyrë që t'i arrijë objektivat në sezonin pranveror në Superligë. "Xhevdet Shabani është një nga përforcimet e radhës në klub deri

më tani. Shabani la FC Prishtinën për t'u bërë pjesë e klubit tonë për pjesën e mbetur të këtij edicioni garash. Në Superligën e Kosovës, për disa vjet radhazi, Shabani ka qenë një ndër futbollistët më të spikatur të kampionatit. Ardhja e tij në FC Malisheva do të jetë një përvojë e veçantë për klubin tonë", thuhet në njoftimin e Malishevës. Karrierën si futbollist Shabani e filloi me Lepencin dhe Ferizajn për të kaluar te FC Drita, më pas duke lënë kampionatin e Kosovës për t'u transferuar te Teuta e Durrësit për sezonin 2014-2015. Pas një sezoni të mirë në kampionatin shqiptar, Shabani nënshkroi me Feronikelin, top-klubin e atëhershëm të Superligës. Luajti edhe për Besën, sërish u rikthye te Drita dhe sezonin e fundit ishte pjesë e FC Prishtinës. "Një përvojë impulsive si në kampionatin kosovar e atë shqiptar, po ashtu edhe në garat evropiane. Të lumtur që Shabani është tashmë pjesë e klubit tonë, ne i dëshirojmë mirëseardhje dhe i urojmë fat të mirë dhe suksese me klubin dhe në sferën personale", thuhet në njoftimin e Malishevës.

Klubi që drejtohet nga Arsim Thaqi sezonin vjeshtor e mbylli në vendin e shtatë me 19 pikë të grumbulluara, ku

nga 18 ndeshje ka regjistruar pesë fitore, katër barazime dhe nëntë humbje.

Dukagjini largon shtatë futbollistë

Skuadrat e Dukagjinit ka nisur përgatitjet për sezonin pranveror dhe po mendon edhe për përforcimin e skuadrës, mirëpo kjo skuadër fillimisht ka vendosur t'i ndërpresë kontratat me disa futbollistë. Fjala është për Ermal Vitinë, Rinor Kuqin, Erblind Mulajn, Amer Dukën, Jozef Kuqin, Moriba Lamah dhe Mhill Grabanicën. "Klubi futbollistik 'Dukagjini' ka ndërprerë bashkëpunimin me marrëveshje të dy anshme me këta futbollistë: Ermal Vitija, Rinor Kuqi, Erblind Mulaj, Amer Duka, Jozef Kuqi, Moriba Lamah, Mhill Grabanica. Falënderojmë secilin prej këtyre futbollistëve që ishin pjesë e jona dhe dhanë kontribut, njëherësh u dëshirojmë shëndet dhe shumë suksese në vazhdim. Klubi njofton se ka huazuar futbollistin Abedin Merlaku te Klubi i Rahovecit për gjashtë muaj", thuhet në njoftimin e skuadrës së Dukagjinit. Klubi nga Klina, po ashtu, ka njoftuar se në ditët e ardhshme do t'i paraqesë transferimet e reja.

SHKURT

Vushtrria transferon Andi Thaqin

FC Vushtrria ka vazhduar të përforcohet për sezonin pranveror në Ligën e Parë të Kosovës në futboll. Transferimi i fundit i skuadrës, e cila synim ka inkuadrimit në Superligë, është portieri Andi Thaqi. "Portieri i njohur 25-vjeçar Andi Thaqi nga Prishtina, i dalë nga academia e Klubit të Futbollit Besa e Pejës, ish-bashkëlojtar i Dior Zabergjes dhe Leart Eminit te KF Arbëria për dy vjet, nënshkruan kontratë me klubin tonë. Ne i dëshirojmë mirëseardhje dhe suksese në misionin drejt rikthimit aty ku e kemi vendin", thuhet në njoftimin e FC Vushtrria.

Sheremeti ndahet me Trepçën '89

Mbrojtësi shtatlartë Beshir Sheremeti ka ndarë rrugët me Trepçën '89. 21-vjeçari bëri debutimin e tij me 89-shin në një moshë shumë të re, duke dhënë shpresa për një siguri të lartë në mbrojtjen e mitrovicasve. Megjithatë, fati nuk ishte me të, pasi pësoi një lëndim të rëndë dhe u operua. Sheremeti është shëruar plotësisht nga lëndimi dhe është i gatshëm për një aventurë të re. Beshir Sheremeti është lojtar i ri dhe disa klube tashmë veçse kanë shprehur interesim për shërbimet e qendërmbrojtësit perspektiv.

'The Sun': Chelsea po projekton të ardhmen me sulmuesin shqiptar

Armando Broja është duke kaluar një moment të jashtëzakonshëm me fanellën e Southamptonit, ndoshta më të mirin në karrierë, duke parë paraqitjet dhe golat e tij të realizuar në vendin ku lindi futbollit. Të magjepsur me golat e tij janë tifozët e Southamptonit të cilët u kanë kërkuar drejtuesve dhe presidentës për ta mbajtur përfundimisht sulmuesin e kombëtares shqiptare. Së fundmi prestigjiozja britanike "The Sun" ka hapur artikullin me titullin se Chelsea e konsideron Armando Brojën pjesë të projektit të ri. Një lajm i rëndësishëm ky për talentin 20-vjeçar i cili do të bënte hapin e madh në karrierë për të qenë në qendër të projektit të klubit që ka në pronësi kartonin e tij, mbi të gjitha te një klub gjigant si Chelsea.

Të gjithë të izoluar në Fshatin Olimpik, pritet vendimi për tifozët

PEKIN, 13 JANAR - Organizatorët e Lojërave Olimpikë dimërore "Pekin 2022" ende nuk kanë vendosur nëse do t'i lejojnë tifozët vendës të ndjekin nga afër këtë event apo jo. Pandemia Covid-19 ka detyruar organizatorët të shtyjnë për disa

ditë vendimin, ndërkohë që tifozët e huaj nuk do të lejohen të hyjnë në Kinë. Në rast se do të ketë tifozë ata do të jenë vetëm fansa vendës. "Presim një përgjigje nga organizatorët", thanë drejtuesit e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.

Është vendosur që të gjithë sportistët, trajnerët, stafet e drejtuesit e delegacioneve olimpikë të qëndrojnë të mbyllur në Fshatin Olimpik, pa pasur mundësi të lëvizin. "Do të jetë një sistem i mbyllur, që do të thotë se të gjithë

pjesëmarrësit, përfshirë vullnetarët, zyrtarët dhe atletët do të jenë brenda zonës së sigurt, brenda çdo vendi dhe infrastrukturës shoqëruese", thanë organizatorët, që shtuan se do të ketë çdo ditë teste kundër Covidit.



Ancelotti: Barça nuk na dominoi, ne shfrytëzuam kundërsulmet

MADRID, 13 JANAR - Reali i Madridit është finalisti i parë i Superkupës së Spanjës pasi e ka mposhtur Barcelonën me rezultat 3-2 në kohën shtesë. Trajneri Carlo Ancelotti ka mundësinë që të dielën të fitojë edhe Superkupën e Spanjës, çfarë do ta bënte atë nga të paktët trajnerë që fiton Superkupën në katër vende të ndryshme.

Trajneri italian e ka fituar me Milanin në Itali, Chelsea në Angli dhe Bayernin në Gjermani. Dhe tani është vetëm një hap larg me Realin e Madridit në Spanjë. "Ishim të përgatitur për një ndeshje të tillë. Siç e thashë edhe para ndeshjes, se do të ishte një përballje e ekuilibruar dhe ashtu rezultoi. Kemi luajtur shumë mirë në pjesën e parë, duke qenë shumë efektive në kundërsulm. Besoj se në tërësi, të dyja ekipet kemi përçarur një imazh mjaft të mirë të futbollit spanjoll", ka thënë Ancelotti, i cili i është kundërpërgjigjur edhe trajnerit të Barcelonës, Xavi Hernandez: "Fjalët



e Xavit? Ai ka mendimin e tij, por nuk jam dakord që Barcelona e ka dominuar ndeshjen. Në pjesën e parë kemi marrë një gol të pafat, ndërsa pjesa e dytë ishte më e baraspeshuar. Por, kemi pasur meritën që kemi qenë rezultativë në kundërsulm, duke shënuar tre gola të mrekullueshëm. Kundërsulmi? Besoj se ka qenë një nga armët tona më të mira në këtë takim. Pastaj me cilësitë që kanë mesfushorët tanë, e

kemi luksin e një loje të tillë. Në këtë takim gjithçka na ka shkuar mirë". Trajneri italian ka folur edhe për finalen e së dielës. "Të them të drejtën nuk kam ndonjë preferencë për finalistin tjetër. Qoftë Atletico e Madridit, qoftë Bilbao janë dy skuadra shumë të mira. E rëndësishme është të argëtohemi me gjysmëfinalen tjetër dhe më pas të mendojmë për finalen", ka shtuar Ancelotti.

Ronaldo: Nuk u riktheva për të dal i shtati

MANCHESTER, 13 JANAR - Në ditët e fundit nga Anglia në Spanjë flitet pafund për situatën që po kalon Cristiano Ronaldo te Manchester United. Flitet për një situatë aspak të lumtur, për një gjendje shpirtërore të trazuar, madje mediet shkojnë deri aty sa flasin për një largim në fund të sezonit nëse "djajtë e kuq" nuk arrijnë të sigurojnë një vend për në Ligën e Kampioneve. As Ronaldo nuk bën shumë për t'i larguar këto zëra, dukshëm jo i plotësuar në këtë rikthim të tij në "pallatin e ëndrrave". "Nuk dëshiroj ta mbyll sezonin në vendin e shtatë, as të arrij në tri vendet e para në Premier Ligë. Dua të fitoj. E di shumë mirë rrugën që duhet të ndjekim, por nuk dua të flas se nuk do të ishte korrekte", u shpreh



Ronaldo. "Fillimisht Solskjaer, më pas Carrick dhe, së fundmi, trajneri i ri. Kur ndryshon kaq shumë është gjithnjë e vështirë. Me Rangnick jemi përmirësuar në disa aspekte, por duhet më shumë kohë.

Mendoj se ai do të bëjë një punë të mirë. Viti i ri, jete e re, shpresoj shumë që Manchester Unitedi të arrijë në ato nivele që tifozët shpresojnë dhe meritojnë", ka thënë Ronaldo.

SHKURT

Barça arrin marrëveshje me Iscon

Barcelona ka arritur një marrëveshje me mesfushorin e Real Madridit, Isco, për një transferim të mundshëm në verë, raporton "El Chiringuito". Mesfushori ka rënë dakord në parim për të kaluar në "Nou Camp". Isco nuk është në formën e tij më të mirë, siç shihet nga nëntë paraqitjet e pakta që ka bërë në La Liga deri më tani. Me skadimin e kontratës së spanjollit në fund të sezonit, kuptohet se presidenti i Barcelonës, Joan Laporta, është i prirë të nënshkruajë me agjentë të lirë për shkak të situatës së tyre të pasigurt financiare dhe se mesfushori u përshtatet faturave për sa i përket llojit të lojtarëve që kërkojnë. Spanjollit mund të operojë në krahë, por është në më të mirën e tij në mesfushën qendrore, duke luajtur menjëherë pas sulmuesit, do të bëhej lojtari i parë që bën lëvizjen mes dy rivalëve që nga viti 2007, me Javier Saviola që është i fundit që ka kaluar.

Qeveria australiane shtyn vendimin për Djokoviçin

Novak Djokoviç vijon të jetë në Melburn, por prania e tij në grand slam të Australian Openit mbetet ende një enigmë. Ministria e Emigracionit ka kërkuar më shumë kohë për ta mbyllur hetimin në lidhje me dokumentacionin (i pavaksinuar) dhe deklaratat e rreme që tenisti serb (intervista kur ishte i infektuar) ka dhënë në kufi, pas mbërritjes. Ndërkohë, organizatorët e grand slam të Australian Openit nuk humbasin kohë dhe kanë hedhur shortin. Në short figuron edhe emri i Novak Djokoviçit, numrit një në botë për meshkuj, që në raundin e parë do të luajë ndaj patriotit të tij Miomir Kecmanoviç. Djokoviç është kampion në fuqi i këtij grand slami, që synon ta fitojë për të 10-n herë.

Lorenzo: Rossi është Maradona i MotoGP

Piloti spanjoll Jorge Lorenzo, ish-kampion bote në MotoGP, dikur ka qenë rival dhe shok skuadre të Yamaha me Valentino Rossin. Tashmë që të dy janë tërhequr nga garat e motoçiklizmit. Gjithsesi Jorge Lorenzo ka folur me superlativa për rivalin italian, për të cilin ka thurur elozhe. "Valentino Rossi ka qenë piloti më i madh në historinë e motoçiklizmit. Ai ishte gjithnjë më i shpejti në pistë dhe ishte vështirë ta mposhtje. Unë mendoj se ai është Maradona i MotoGP, me personalitet dhe persona të tillë nuk lindin shpesh në sportin tonë", ka thënë Lorenzo.

Atletico Mineiro transferon Diego Godinin

Atletico Mineiro ka bërë zyrtare nënshkrimin me qendërmbrojtësin Diego Godin. Uruguaiiani ka nënshkruar kontratë deri në fund të sezonit, me opsion rinovimi për një tjetër vit. Këtë e bëri me dije skuadra e Atletico's përmes një postimi në rrjetin social "Twitter". "Uruguaiiani mbrojtës ka nënshkruar deri më 12.31.2022 me opsion rinovimi dhe është përforcimi i radhës", thuhet në njoftimin e klubit.

Allegri: Humbja pesë sekonda nga fundi dhemb, futbollit sikur është shpikur nga djalli

Interi dhe Juventusit u përballën mes tyre për trofeun e parë këtë sezon, sfidë që nxori fituese skuadrën e Simone Inzaghit. Një gol në minutat e fundit të ndeshjes bëri që Interi ta rrëmbente trofeun e Superkupës. Pas

humbjes te skuadra e Juventusit ishin shumë të zhgënjyer, teksa trajneri Missimiliano Allegri pas ndeshjes është shprehur se duket sikur futbollin e ka shpikur djalli. "Ishte një lojë e vërtetë, një test i mirë për ne

për të parë se ku jemi. Fatkeqësisht, futbollit ndonjëherë duket sikur është shpikur nga djalli. Bëmë një gabim naiv pesë sekonda nga fundi, por luajtëm kundër ekipit më të fortë në Itali për momentin dhe patëm disa

raste, duke i lejuar Interit shumë pak. Ne luftuam në 10 minutat e parë, por më pas bëmë shumë mirë", ka thënë Allegri. "Një humbje pesë sekonda nga fundi dhemb, por ne duhet ta përdorim atë zemërim për Serinë A, Kupën

e Italisë dhe Ligën e Kampioneve. Duhet të shohim anë të pozitive, skuadra po përmirësohet, veçanërisht fizikisht. Ishte një lojë e vetme. Nuk shkoj ashtu siç donim, kështu që tani fokusohemi në ligë", ka shtuar Allegri.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Pekara Vodenica “ DOO, Marko Nikolic ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810328022, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Pekara Vodenica” DOO Marko Nikolic donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810328022, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Pekara Vodenica” DOO Marko Nikolic has come to the decision to quit its business: 810328022, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Branimir Mlladenovic, shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Xhylnaze Cena shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shfmu " Lidhja e Prizrenit " Prizren.
- ▶ Gezim Duraku shpall te pavlefshme dëftesat e kl I- V dhe VI - IX shfmu " Bajram Curi " Krushe e Madhe.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal in më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

